



BASHKIA
TIRANË

- Drejtuar:**
- 1. Shoqërisë “Dorina Karaj”**
Adresa: Rruga “Skwnderbej” Pall 8, kati i parë, Tiranë.
 - 2. Shoqërisë “Odisea Travel & Tours”**
Adresa: Rruga “Njwsia Bashkiake nr.5, Bulevardi Bajram Curri, Ndertesa 118, Hyrja 4, Ap. 3, Kodi Postar1019, Tiranw.
 - 3. Shoqërisë “Concord-Travel Tours”**
Adresa: Bulevardi ” Dëshmorët e Kombit, kullat binjake, kulla Nr. 2, kati I, Tiranë
 - 4. Shoqërisë “Planet”**
Adresa: Sheshi Skwnderbej, Pallati i Kulturws, K.1, Tiranw

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

Procedura e prokurimit: e zgjedhur në mbështetje të ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 30 si dhe Neni 35/1 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” kreu IV, Neni 33; si dhe Kreut V, Neni 45, pika 1, udhëzimit Nr 10 dt. 01.11.2017 për ”Disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr 6 dt. 27.01.2015” për përdorimin e marrëveshjes kuadër” (i ndryshuar), si edhe rekomandimit Nr. 13566 Prot dt 06.11.2017 nga Agjensia e Prokurimit Publik është **“Procedurë e Hapur/marrëveshje kuader”**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“ Blerje bileta udhëtimi për transport ajror ndërkombëtar për Bashkinë Tiranë për vitin 2018”**, per ofrimin e shërbimit për bileta udhëtimi sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Fondi limit: **15.000.000 (pesëmbëdhjetë milion)** lekë pa tvsh.

Burimi i financimit: Të ardhura - vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2018”.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **26.01.2018, ora 12:00**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: **Buletini i Njoftimeve Publike Nr 01 datë 08.01.2018.**

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “AR & LO” shpk NUIS- L01305031H

Vlera e ofertës pa tvsh shprehur me marzh fitimi në % = **0.001%**.

2. Operatori ekonomik “Dorina Karaiskaj” NUIS K91425009A

Vlera e Ofertës pa tvsh shprehur me marzh fitimi në % = **0.01%**

3. Operatori ekonomik “Golden Travel” NUIS L31310007Q

Vlera e Ofertës pa tvsh shprehur me marzh fitimi në % = **0.01%**.

4. Operatori ekonomik “Odisea Travel & Tours” NUIS : K31611085A

Vlera e Ofertës pa tvsh shprehur me marzh fitimi në % = **0.01%**.

5. Operatori ekonomik “Concord-Travel Tours” NUIS: K51516032L

Vlera e Ofertës pa tvsh shprehur me marzh fitimi në % = **0.1%**.

6. Operatori ekonomik “Planet” NUIS K51810504P

Vlera e Ofertës pa tvsh shprehur me marzh fitimi në % = **0.98%**.

7. Operatori ekonomik “Global Travel” NUIS K51822002G

Vlera e Ofertës pa tvsh shprehur me marzh fitimi në % = **1%**.

8. Operatori ekonomik “Albtours ”D”-VAS tour NUIS 41423004O

Vlera e Ofertës pa tvsh shprehur me marzh fitimi në % = **0.01%**.

Janë skualifikur ofertuesit e mëposhtëm

1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Global Travel”

Për arsyet si më poshtë vijon:

- Shoqëria “Global Travel” ka paraqitur certifikatën e akreditimit të lëshuar nga IATA të vlefshme për vitin 2018 e cila është paraqitur e papërkthyer në gjuhën shqip duke rënë në kundërshtim me pikën 4.6 të Njoftimit të Kontratës pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit në të cilën është parashikuar se gjuha për hartimin e ofertës dhe dokumentave është gjuha shqipe si dhe me kriteret e përgjithshme të kualifikimit ku përcaktohet se: *“Nëse gjuha e përdorur në procedurën e prokurimit është shqip atëhere dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”*.
- Shoqëria “Global Travel” nuk përmbush kriterin e përcaktuar tek kriteret e vecanta për kualifikim në rubrikën “Kapaciteti teknik” pika 4 ku parashikohet se ofertuesi i mundshëm duhet të paraqesë:

*“Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën **Janar 2017 –Nëntor 2017”**”.*

Kjo shoqëri ka paraqitur vetëm listpagesat për muajin Janar-2017-Nëntor 2017 dhe urdher pagesat por jo vërtetimin e lëshuar nga Administrata Tatimore.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Albtours ”D”-VAS tour”

Për arsyet si më poshtë vijon:

Në dokumentat e tenderit Shtojca 7 ”Kriteret e veçanta të kualifikimit”, ”Kapaciteti ekonomik dhe financiar” (modifikuar nga autoriteti kontraktor), pika 2 është përcaktuar kriteri si më poshtë vijon: *“Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2017.*

Nga verifikimi në S.P.E (sistemin e prokurimeve elektronike) të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues **”Albtours ”D”-VAS tour operatore”** rezulton se në përmbushje të kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit nga operatori ekonomik sa më sipërcituar është paraqitur:

1. Vërtetimi i datës 19.01.2018 lëshuar nga Bashkia Tiranë, sipas së cilës shoqëria ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2017.

Nga verifikimi i kryer në Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit **”Albtours ”D”-VAS tour operatore**, në rubrikën “Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit” rezulton se aktualisht kjo shoqëri ushtron aktivitet dhe është operativ në Fier, dhe Durrës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e përmbushjes së kërkesës së autoritetit kontraktor për shlyerjen e detyrimeve të taksave vendore

siç është parashikuar në dokumentat e tenderit, pasi dokumentacioni i paraqitur prej tij vërteton shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore vetëm për Bashkinë e Tiranë; ndërkohë që nuk vërteton shlyerjen e këtyre detyrimeve për Bashkinë Fier dhe Bashkinë Durrës ku ai rezulton të jetë operativ.

Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, 7 parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

Në vijim në Nenin 12 “Regjistrimi dhe Liçensimi” të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikohet se: Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Në pikën 6 të këtij neni citohet gjithashtu se: “Kur taksapaguesi kryen një biznes në më shumë se një vendndodhje, ai pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo vendndodhje të biznesit dhe taksa llogaritet më vete për çdo vendndodhje”.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Golden Travel”

Për arsyet si më poshtë vijon:

Shoqëria “Golden Travel” në përmbushje të kërkesës për realizimin e shërbimeve të së njëjtës natyrë ka paraqitur dokumentacionin për sa më poshtë vijon:

1. Marrëveshje kuadër me Nr.5115/1 Prot dt 15.06.2015 e lidhur midis Ministrisë së Bujqësisë dhe operatorëve ekonomikë “Golden Travel”, operatorit ekonomik “Dorina Karaiskaj” dhe operatorit ekonomik “Odisea Travel & Tours” dhe vërtetimin e realizimit me Nr 2048 Prot dt 15.03.2016 te pashoqeruara me minikontratat perkatese rast pas rasti.
2. Marrëveshje kuadër me Nr.3452/4 Prot dt 02.07.2015 e lidhur midis Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe operatorëve ekonomikë “Golden Travel”, operatorit ekonomik “Dorina Karaiskaj” dhe operatorit ekonomik “Odisea Travel & Tours” te pashoqeruara me minikontratat perkatese rast pas rasti.
3. Marrëveshje kuadër me Nr.3942/7 Prot dt 29.08.2016 e lidhur midis Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe operatorëve ekonomikë “Golden Travel”, operatorit ekonomik

“Dorina Karaiskaj”, operatorit ekonomik “AR & LO”, operatorit ekonomik “Planet”, dhe operatorit ekonomik “Spirit Travel & Tours” dhe vertetim realizimi e lëshuar nga Ministria e Zhvillimit Urban me Nr 334/1Prot dt 23.01.2017 te pashoqeruara me minikontratat perkatese rast pas rasti.

4. Minikontrate Nr. 2527 Prot dt 07.09.2017 e lidhur midis shoqërisë “Golden Travel” dhe Autoritetit Kontraktor “Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare” me objekt: “Blerje 2 bileta avioni me itenerar “Tiranë-Vjenë –Tiranë, nisja dt 17.09.2017 nga Tirana dhe kthimi ne dt 19.09.2017 nga Vjena me vlerë 166.250 (njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë.
5. Marrëveshje kuadër me Nr.653/11 Prot dt 05.04.2016 e lidhur midis Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes (Agjencia Kombetare e turizmit) dhe operatorëve ekonomikë “Golden Travel”, operatorit ekonomik “Dorina Karaiskaj”, operatorit ekonomik “Odisea Travel &Tours”, dhe vërtetimin e realizimit me Nr 362/1 Prot dt 01.02.2017 te pashoqeruara me minikontratat perkatese rast pas rasti.
6. Marrëveshje kuadër me Nr.2269/6 Prot dt 28.02.2017 e lidhur midis OSHEE dhe operatorëve ekonomikë “Golden Travel”, dhe bashkimit të operatoreve ekonomikë “Spirit Travel & Tours & Planet” dhe vërtetimin e realizimit me Nr 541/3 Prot dt 29.01.2018 te pashoqeruara me minikontratat perkatese rast pas rasti.
7. Marrëveshje kuadër me Nr.5687/8 Prot dt 16.06.2015 e lidhur midis Ministrise se Financave dhe operatorëve ekonomikë “Golden Travel”, operatorit ekonomik “Dorina Karaiskaj” dhe opeatorit ekonomik “AR & LO” dhe vërtetimin e realizimit me Nr 4711 Prot dt 04.04.2016 te pashoqeruara me minikontratat perkatese rast pas rasti.
8. Marrëveshje kuadër me Nr.37/20 Prot dt 24.02.2016 e lidhur midis Ministrise se Financave dhe operatorëve ekonomikë “Golden Travel”, operatorit ekonomik “Dorina Karaiskaj” dhe opeatorit ekonomik “AR &LO” dhe Vertetim realizimi e lëshuar nga Agjensia Kombetare e Turizimit me Nr 35 Prot dt 24.01.2017 te pashoqeruara me minikontratat perkatese rast pas rasti.
9. Marrëveshje kuadër me Nr.9201/5 Prot dt 06.07.2017 e lidhur midis Bashkisë Tiranë dhe operatorëve ekonomikë “Golden Travel”, operatorit ekonomik “Global Travel” dhe opeatorit ekonomik “Concord Travel & Tours” dhe vertetim realizimi e lëshuar nga Bashkia Tiranë me Nr 362/1Prot dt 01.02.2017 te pashoqeruara me minikontratat perkatese rast pas rasti.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit në pikën II pika 1 rubrika (Kapaciteti Teknik) parashikohet se:

2. *Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej 40% e vlerës se fondit limit ose ne vleren 6.000.000 (gjashtë milion) leke pa tvsh, të realizuara gjatë tre viteve të fundit.*
 - *Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik*

do ta vërtetoje duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, te shoqeruar me vërtetimin e realizimit te leshuar nga institucioni.

- Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes ku te shenohen datat, dhe te jete i specifikuar shërbimi i kryer te nënshkruara nga te dyja palet.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i dokumentacionit, të paraqitur nga shoqëria “Golden Travel” në përmbushje të kriterit sa më sipërcituar si dëshmi provuese për përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi, konkludon se marrëveshjet kuadër të paraqitura nga shoqëria “Golden Travel”, në mbështetje të udhëzimit Nr. 6, datë 27.01.2015 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër” (i ndryshuar) nuk përbëjnë një kontratë publike por që këto marrëveshje të bëhen efektive dhe operative mbi bazën e tyre duhet të lidhen minikontratat në të cilën përcaktohen në mënyrë konkrete dhe rast pas rasti të dhënat thelbësore të një kontrate të cilat janë objekti i saj, vlera monetare si edhe afati për kryerjen e shërbimit, mallit apo një pune konkrete. Theksojme se Marrëveshja kuader nuk është një procedurë prokurimi por një mënyrë prokurimi produkt i të cilës është procesi i minikonkurrencës dhe minikonkurrenca prodhon në vetvete një kontratë.

Thënë sa më sipër marrëveshja kuadër nuk është një kontratë në vetvete por përcakton kushtet mbi bazën e të cilës do të lidhen minikontratat rast pas rasti sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Pra referuar dispozitave ligjore sa më sipërcituar operatori ekonomik duhet të kishte paraqitur të gjitha minikontratat apo faturat tatimore të lidhura në zbatim të marrëveshjes kuadër si dokumentacion provues për përmbushjen e kriterit sa më sipërcituar duke qënë se është kërkuar domosdoshmërisht se ofertuesi i mundshëm duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar me institucionin të shoqëruar me vërtetimin e realizimit nga institucioni.

Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, 7 parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

4. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “AR & LO” shpk

Për arsyet si më poshtë vijon:

1. Marrëveshje kuadër me Nr.258 Prot dt 14.06.2016 e lidhur midis Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe operatorëve ekonomikë “Odisea Travel & Tours” dhe operatorit ekonomik “AR & LO” dhe vertetim realizimi nr. ekstra Prot dt 02.02.2017, te pashoqeruara me minikontratat perkatese rast pas rasti.
2. Marrëveshje kuadër me Nr.1078/10 Prot dt 04.05.2016 e lidhur midis Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) dhe operatorëve ekonomikë “Odisea Travel & Tours” dhe operatorit ekonomik “AR & LO” dhe vertetim realizimi nr. 1548 Prot dt 15.03.2016 te pashoqeruara me minikontratat perkatese rast pas rasti.
3. Marrëveshje kuadër me Nr.40/11 Prot dt 03.12.2015 e lidhur midis Kuvendit të Shqipërisë dhe operatorit ekonomik “AR & LO” dhe vertetim realizimi nr. 349/1 Prot dt 02.02.2017 te pashoqeruara me minikontratat perkatese rast pas rasti.

Nga ana e Autoritetit Kontraktor në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave standarte të tenderit në pikën II pika 1 rubrika (Kapaciteti Teknik) parashikohet se:

3. *Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej 40% e vlerës së fondit limit ose në vlerën 6.000.000 (gjashtë milion) leke pa tvsh, të realizuara gjatë tre viteve të fundit.*
 - *Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë **duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin**, te shoqeruar me vertetimin e realizimit të leshuar nga institucioni.*
 - *Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të shenohen datat, dhe te jete i specifikuar shërbimi i kryer te nënshkruara nga te dyja palet.*

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i dokumentacionit, të paraqitur nga shoqëria “AR & LO” në përmbushje të kriterit sa më sipërcituar si dëshmi provuese për përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi, konkludon se marrëveshjet kuadër të paraqitura nga kjo shoqëri, në mbështetje të udhëzimit Nr. 6, datë 27.01.2015 “Për përdorimin e marrëveshjes kuadër” (i ndryshuar) nuk përbëjnë një kontratë publike por që këto marrëveshje të bëhen efektive dhe operative mbi bazën e tyre duhet të lidhen minikontratat në të cilën përcaktohen në mënyrë konkrete dhe rast pas rasti të dhënat thelbësore të një kontrate të cilat janë objekti i saj, vlera monetare si edhe afati për kryerjen e shërbimit, mallit apo një pune konkrete. Thëksojme se Marrëveshja kuadër nuk është një procedurë prokurimi por një mënyrë prokurimi produkt i të cilës është procesi i minikonkurrencës dhe minikonkurrenca prodhon në vetvete një kontratë.

Thënë sa më sipër marrëveshja kuadër nuk është kontratë në vetvete por përcakton kushtet

mbi bazën e të cilës do të lidhen minikontratet rast pas rasti sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Pra referuar dispozitave ligjore sa më sipërcituar operatori ekonomik duhet të kishte paraqitur të gjitha minikontratet apo faturat tatimore të lidhura në zbatim të marrëveshjes kuadër si dokumentacion provues për përmbushjen e kriterit sa më sipërcituar duke qënë se është kërkuar domosdoshmërisht se ofertuesi i mundshëm duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar me institucionin të shoqëruar me vërtetimin e realizimit nga institucioni.

Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar **si operatorë ekonomikë të suksesshëm:**

1. **Operatori ekonomik “Dorina Karaiskaj” shpk** NUIS- K91425009A

Vlera e ofertës pa tvsh shprehur me marzh fitimi në % = **0.01%**.

2. **Operatori ekonomik “Odisea Travel & Tours”** NUIS: 51810504P

Vlera e Ofertës pa tvsh shprehur me marzh fitimi në % = **0.01%**.

3. **Operatori ekonomik “Concord Travel & Tours”** NUIS K51822002G

Vlera e Ofertës pa tvsh shprehur me marzh fitimi në % = **0.1%**.

4. **Operatori ekonomik “Planet”** NUIS K51810504P

Vlera e Ofertës pa tvsh shprehur me marzh fitimi në % = **0.98%**.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 05 .02.2018.

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë,

është paraqitur Formulari i Ankesës nga operatori ekonomik “Ar & Lo” shpk hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 5853 Prot. datë 08.02.2018, (administruar në dosjen e prokurimit), në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje bileta udhëtimi për transport ajror ndërkombëtar për Bashkinë Tiranë për vitin 2018”.

Me marrjen e ankesës nga operatori ekonomik i mësipërm në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 ”Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) me Urdhërin me Nr. 5868 Prot. dt. 08.02.2018 u pezullua procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma ”a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar) me Urdhërin me Nr. 5868/1 Prot. dt. 08.02.2018 u ngrit Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konkludoi me marrjen e një vendimi, ku vendosi të mos e pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik i mesipërm duke i kthyer përgjigje operatorit ekonomik me anë të shkresës me Nr 5868/3 Prot dt 12.02.2018 (kthim përgjigje e administruar ne dosjen e procedures). Autoriteti Kontraktor e ka mbajtur te pezulluar procedurën e prokurimit për të pritur nëse pala ankimuese sa më sipërcituar do ta ushtronte të drejtën e tij për t’u ankimuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik si organi më i lartë vendimmarrës në fushën e prokurimit publik. Duke qënë se operatori ekonomik «AR & LO» shpk nuk është ankimuar pranë KPP, vendosi të kryejë heqjen e pezullimit të kësaj procedure me anë të shkresës me Nr 5868/4 dt 22.02.2018 duke vijuar me tej procedurën e prokurimit.

